Kronikë

Vlorë, plumb në kokë 23 vjeçarit në ballkon, po pinte cigare! Dyshohet se u ekzekutua me snajper! 2 persona ndihmuan autorin të largohej

*Policia vijon hetimet për të zbardhur ekzekutimin e tipit mafioz të 23-vjeçarit Gëzim Sinomati. I riu u qëllua me snajper në ballkonin e banesës në Vlorë ku **kishte dalë të pinte cigare.** Një plumb i mori jetën, ndërsa pas vrasjes u fikën dritat në zonën përreth. 14 persona janë shoqëruar deri tani. Mjeti i autorëve u djeg në lagjen 24 Maj, por arma e krimit nuk është gjetur.*

■ 23-vjeçari ekzekutohet në ballkonin e banesës sapo u kthye nga Belgjika! Autorët djegin makinën

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
8 Janar, 07:02 | **Përditësimi: 8 Janar, 11:26**

Share

VLORË- Një plumb në kokë i mori jetën 23-vjeçarit Gëzim Sinomati, i cili u ekzekutua mbrëmjen e 7 janarit 2024, teksa ishte në ballkonin e banesës në katin e tretë të një pallati në lagjen "Hajro Çakërri' në Vlorë.

I riu, sapo ishte kthyer nga Belgjika dhe kishte dalë të pinte cigare në ballkon kur dyshohet se u qëllua me snajper, një ekzekutim i tipit mafioz të cilit nuk i mbijetoi dot.

Burime për gazetarin e Report Tv, Armand Xhelili thonë se ekzekutori dyshohet se ka qenë një person, i cili më pas është ndihmuar nga 2 persona të tjerë për t'u larguar nga vendi i ngjarjes. Ndërkohë, sapo i riu është qëlluar me plumb në kokë, dritat në zonë janë fikur dhe qyteti ka qenë në errësirë.

Nuk dihet nëse kjo ishte planifikuar nga autorët apo ka qenë thjesht një rastësi, por ekzekutori ka përfituar nga errësira për t'u larguar pa lënë gjurmë. Deri më tani janë shoqëruar në polici 14 persona, të cilët janë marrë në pyetje për vrasjen.

LEXO EDHE:
Vlorë, 23 vjeçari ekzekutohet në ballkonin e banesës, dyshohet se u qëllua me snajper! Sapo ishte kthyer nga Belgjika! Autorët djegin makinën (EMRI+ VIDEO)

Ndërkohë, pesë minuta pas ***ekzekutimit***, në lagjen 24 'Maji' është djegur dhe automjeti që policia thotë se dyshohet se është përdorur nga autorët. Burimet thonë se deri më tani nuk është gjetur ende arma e krimit. Ndërsa mjeti rezulton me targë të dubluar me në Kamzë të Tiranës.

Një nga pistat e hetimit për vrasjen është hakmarrja, por dyshohet dhe ajo e trafikut të drogës apo konfliktet mes grupeve kriminale.

Kush është Gëzim Sinomati?
Gëzim Sinomati është djali i ***Sokol Sinomatit*** i njohur si 'buzëderri', ish-anëtarit të bandës së Gaxhait në vitin 1997 në Vlorë i cili është arrestuar për vrasjen e një personi në vitin 2000. Ndërsa 2 vite më parë, në 3 janar të vitit 2022, xhaxhait të viktimës, ***Bernardo Sinomatit*** i vunë 150 gramë lëndë plasëse tritol në makinën që e kishte parkuar në të njëjtën lagje ku mbrëmjen e sotme iu ekzekutua nipi 23 vjeçar.

Prej 12 shtatorit 2017 Sokol Sinomati rezulton në kërkim pasi kishte marrë leje në burgun e Peqinit dhe nuk u kthye më. Menjëherë, sapo doli nga burgu, ai mori të vëllanë Bernard Sinomatin dhe djalin e tij dhe u largua nga Shqipëria. Dyshohet se u vendosën në Belgjikë nga ku dhe ishte kthyer djali i tij për të festuar Vitin e Ri. Në vitin kur ai u arratis, Sokol Sinomataj vazhdonte të vuante dënimin për vrasjen e Elton Tatos dhe plagosjen e Robert Borakut, ngjarje që sipas vendimit të gjykatës së Vlorës ka ndodhur në 26 qersshor 2002.

Lajmi ne perditesim...

Sl.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Vlore | Gëzim Sinomati | vrasja e gezim sinomatit | sokol sinomati | bernardo sinomati

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sa shqetësues është për ju bullizimi në rrjetet sociale?

Shumë | Pak | Aspak

Lajme të tjera

Besimtarët ortodoksë kremtojnë ditën e Ujit të Bekuar
6 Janar, 15:35

Kërcënuan 33 vjeçarin me armë zjarri, shpallen në kërkim tre të rinj në Vlorë
5 Janar, 18:03

EMRAT/ Me armë e lidhëse në makinë për të marrë peng një 49-vjeçar, arrestohen 4 të rinj në Sarandë! Do ta rrëmbenin për një borxh të pashlyer
5 Janar, 11:53

Vlorë/ Gjendet e mbytur një grua në zonën e 'Ujit të Ftohtë' (VIDEO)
4 Janar, 09:29

Aksident në Vlorë, makina përplas 8 vjeçarin
3 Janar, 14:06

Festa në atdhe/ Emigrantët largohen pas festave, s'ka radhë në pikat kufitare
3 Janar, 10:51

Tenton të fusë kokainë në burgun e Vlorës, e kishte fshehur mes patateve
3 Janar, 10:06

Tentoi të godasë me shkelm një person, pezullohet nga detyra polici në Vlorë
2 Janar, 15:40

Vlorë/ Shisnin lëndë piroteknike, vihen nën hetim 2 persona, sekuestrohen fishekzjarre dhe kapsolla me vlerë rreth 800 000 lekë
2 Janar, 10:57

Gjashtë aksidente në rrugët e vendit në ditën e parë të vitit, dhjetë të lënduar! Faji i shoferëve
1 Janar, 22:50

TEC-et lundruese ankorohen prej një viti në Vlorë, por s'prodhojnë energji! Ende s'ka datë kur vihen në punë
1 Janar, 20:19



Vlorë, dy persona përfundojnë në spital pas një sherri
1 Janar, 01:31

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje